

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr.354/ 21

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimin të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE” D &T Group shpk & Florida shpk & Horn& Co Kosova shpk me seli në Gjakovë , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa I-rë-Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me numër të prokurimit :AP 632/19/7809-2-1-1, të iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 07.05.2021 mori këtë :

VENDIM

- I. Hedhet si e pa lejuar** ankesa e “D &T Group shpk & Florida shpk & Horn& Co Kosova shpk me seli në Gjakovë me nr. të protokollit. 354/21, e 28.04.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa I-rë-Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me numër të prokurimit :AP 632/19/7809-2-1-1, të iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës .

- II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – Komuna e Gjakovës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa I-rë-Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me numër te prokurimit :AP 632/19/7809-2-1-1, të iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës , përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër).
- III. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është proceduar sipas nenit 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës.
- IV. **Obligohet**, OE ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 28.04.2021, Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE “D &T Group shpk & Florida shpk & Horn& Co Kosova shpk me seli në Gjakovë e cila ankesë protokollohet me nr. të protokolli. 354/21, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa I-rë-Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me numër te prokurimit :AP 632/19/7809-2-1-1, të iniciuar nga AK Komuna e Gjilanit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE D &T Group shpk & Florida shpk & Horn& Co Kosova shpk me seli në Gjakovë, me nr. të protokolli. 354/21, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa I-rë-Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me numër te prokurimit :AP 632/19/7809-2-1-1, të iniciuar nga

AK Komuna e Gjakovës dhe bazuar në verifikimin e shkresave të lendes si dhe në platformën e-prokurimi kjo ankesë hedhet si e pa lejuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se Vendimi i AK-së dhe Letra standarde për eliminim është e dt. 02.04.2021

Kundër vendimit të lartcekur OE D&T Group shpk & Florida shpk & Horn&Co Kosova shpk”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK me datë 07.04.2021 në ora 15:06 h.

AK KK Gjakove pretendon se e ka ngarkuar vendimin në kërkesën për rishqyrtim me datën 13.04.2021, kurse në sistem tek përgjigjet në kërkesën për rishqyrtim nuk e gjejmë vendimin në fjale por të njëjtin e gjejmë tek pjesa tjetër “Dokument shtojca” ku vendimi shihet se është ngarkuar me datë 13.04.2021.

Mbas verifikimit kemi kërkuar sqarime nga KRPP-ja dhe na është kthyer përgjigjja me email, me dëshmi se vendimi i AK-së është proceduar me dt.13.04.2021, tek pjesa “Dokument shtojca”

Dëshmi kemi kërkuar edhe nga AK-ja ku verifikohet se me dt.13.04.2021 është proceduar vendimi në kërkesë për rishqyrtim në E-prokurim.

Ankesa në OSHP është parashtruar me dt.28.04.2021 në ditën e 15-të kalendarike mbas vendimit në kërkesë për rishqyrtim dhe si e tillë ankesa në OSHP është parashtruar si e jashtëafatshme

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se duke pas parasysh faktin se AK ka publikuar vendimin OE ankues lidhur me kërkesën për rishqyrtim me datën 13.04.2021, afati ligjor për ankese për OE ankues në Organi Shqyrtues të Prokurimit ka filluar të rrjedhë nga data 14.04.2021 ora 08:00 deri në orën 16:00 dhe ky afat ligjor ka përfunduar me datën 23.04.2021 në ora 16:00. Andaj duke pas parasysh faktin se OE ankues ka parashtruar ankese në OSHP me datën 28.04.2021, ankesa e tij hedhet si e pa leja nga se OE ankues ka humbur afatin ligjor prej 10 ditëve për parashtrim të ankesës në OSHP ashtu siç parashihet me nenin 108/A dhe 109 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE ankues, ankesën me numër të protokollit 354/21 të datës 28.04.2021, e ka parashtruar në kundërshtim me neni 109 të LPP-së sepse neni 109 i LPP-së specifikon:

Afatet për Dorëzimin e Ankesës

1. Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.
2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Po ashtu edhe nenin 9 paragrafi 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE: "D &T Group shpk & Florida shpk & Horn& Co Kosova shpk me seli në Gjakovë" e dt. 28.04.2021, me numër të Protokollit 354/21, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP në kundërshtim me nenin 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.


Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Gjakovës

1x1 OE "D &T Group shpk & Florida shpk & Horn& Co Kosova shpk me seli në Gjakovë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së

Ardian BEHRA

